



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 18.10.2024

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ngritja e qendrës për trajtimin e kafshëve të rrugës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV- Punime ndërtimi 45210000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT: 16.665.992 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË
KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.325, datë 11.09.2024 të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondit limit,
2. Shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës.

I. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76 , sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

a) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në përfundim të punës së grupit u vërejt se:

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin për projekt zbatimin e objektit: “Ngritja e qendrës për trajtimin e kafshëve të rrugës”.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve bazuar në një metodologji të paracaktuar, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë 16.665.992 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 112 (njëqind e dymbëdhjetë) ditë.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe përllogatur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së nr.162/2020, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme, (sipas shtojcës 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 16.000.000 lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar nënin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 8.000.000 Lek, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 32.000.000 lek.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, *të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.*
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Referuar fondit limit sipas nenin 39 pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP – 1 A *Punime gjërmimi në tokë;*
- b. NP – 2 A *Ndertime civile dhe industriale;*
- c. NP – 11 A *Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, linjat e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;*
- d. NS – 2 A *Impiante hidro-termosantare dhe mirëmbajtja e tyre;*
- e. NS – 4 A *Punime rifiniture te muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;*
- f. NS – 18 A *Punime topogjeodezike.*

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pikat e licencës dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilën kategori.*

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PERSHKRIMI I KATEGORISË SIPAS LEGJISLACIONIT TË FUSHËS	ZËRAT E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE	NIVELI I KLASIFIKIMIT I KËRKUAR PËR KATEGORINË RESPEKTIVE	VLERA E PUNIMEVE QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PREVENTIV, QË PËRFSHIHEN NË KATEGORINË PËRKATËSE
NP -1 A	Punime gërmimi në tokë;	2.30 Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me zhinxhir 0.5m ³ shkarkim në auto 2.37/1b Transport materiale ndërtimi dhe me auto deri 6km 3.87/a Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në toke 2.19 Hedhje. Rrafshim, mbushje dhe me krah kategoria 3	A, 0-20 milion lek	346 091 lek
NP-2 A	Ndërtime civile dhe industriale	2.258 Nenshtrese zhavori poshte shtreses niveluese te betonit nen themele (20 cm) 2.262/5 Shtrese betoni C20/25	A, 0-20 milion lek	10,210,502 Lek

		<p>114 Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m3 C - 16/20</p> <p>2.117/1b Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m</p> <p>2.125/1 Soleta b/a monolite me tulla me 6 vrima, Hd = 6m, trashesi 25cm C 16/20</p> <p>2.262/4 Shtese betoni C16/20 , soleta</p> <p>2.119/1a Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m</p> <p>2.166 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm</p> <p>2.166/1a " F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm"</p> <p>2.181 F V konstruksione metalike te perbera (ambjenti I hapur, kafazet, muri rrethues)</p> <p>3.793 F.V. rrjete zingat, per kafazet</p> <p>3.721 F.V. Llamarine xingat e valezuar</p> <p>3.229/2 Shtrese binderi me zall lavatrice, 6cm, me makineri</p> <p>3.226/1 Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri</p> <p>2.262/4 Shtese betoni C16/20</p> <p>3.164/1b Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri per mbushje</p> <p>3.616 F V bordura betoni 12x25 cm</p> <p>2.262/1 Shtrese betoni C 7/10 nen bordura</p> <p>3.643 Mbjellje bari ne skarpat An F.V tuba PE SN8 Ø 250</p> <p>2.342 Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize</p> <p>2.182 F V konstruksione metalike te thjeshta</p> <p>3.793 F.V. rrjete zingat</p> <p>2.390/1 F.V dyer metalike te jashtme</p> <p>2.71/2 "Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25"</p>		
--	--	---	--	--

		2.86 Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15		
NP-11 A	Ndërtimë për nënstacione, kabinat e transformatorëve, linjat e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	<p>2.490/d F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)</p> <p>2.490/f F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)</p> <p>2.547 Panel I matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste</p> <p>2. a-108 Automat magneto-termik 380V,25A, 4P</p> <p>2.490/1 F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A, dl=0.03A</p> <p>2,101 F.V. automat termo.manjetik diferencial 2p220v,20Adl=0,03A</p> <p>2.490/1bF.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A</p> <p>2a,120 F.V. Lampa sinjalizimi 220v 1,2ë</p> <p>4,155/4 F.V. kuti shperndarese PT7,PT8, PT11</p> <p>2.481/1 F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2</p> <p>2.481/2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2</p> <p>2.481/3 F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2</p> <p>2.481/5 F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm2</p> <p>2.481/4 F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2</p> <p>4.131/3.7 F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x25mm2</p> <p>An.1 kabell interneti cad 6</p> <p>2.a-93 F.V. Percjelles CU per tokezim d=25mm2 I zhveshur</p> <p>480/5 Tub shllang Ø 32-36mm</p> <p>480/1 Tub shllang Ø 14-17mm</p> <p>2.480/3 Tub shllang Ø 22-26mm</p>	A, 0-20 milion lek	1,486,541 Lek

		<p>2.483 Çelsa nje polar 10A 280V komplet</p> <p>2.487/e F.V kuti suport pllaket 2 modular</p> <p>2.485/e F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54</p> <p>2.485/d Priza shuko universale Komplet</p> <p>2.485/b F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T</p> <p>2.483 Priza per internet komplet</p> <p>An.2 Ndricules Katror LED me24ë , 6000K,2400lm,</p> <p>An.3 16 Port Rackmount Sëitch profesional</p> <p>2a-139 FV ndricues evakuimi 1x11ëIP40</p> <p>An.4 FV Fiber Optike, 8 core, Multi Mode per instalim</p> <p style="text-align: center;">Shuma I NDRICIMI I JASHTEM</p> <p>An5 FV. Shtylle ndricimi dekorative Cilindrike H = 7.8 m me dy diametra D1 114 dhe D2 76 e zinguar dhe e Iyer me boje elektrostastatike me pjekje ne temp 400°C e kompletuar me morsete, kapak, sigures me spesor 2.5 - 3.5 mm. Shoqcruar me nje ndricues dekorativ LED OSRAM ku duhet te jete jo me i vogel se 21000 Im, me ngjyre drite 4000K me lente polikarbonat asimetrice dhe guarnicion sillkoni. Ndriculesi duhet pa krah dhe i futur ne shtyll . Karkasa e ndricuesit duhet te jete alumln jonidizuar dhe i lyer me te njejten ngjyre te shtylles.</p> <p>3.172 F.V. Kuader komandimi komplet me automat dhe fotoelement</p> <p>3.654/1 Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 80</p> <p>An.6 F.V. Puseta elektrike 30*30</p>		
--	--	--	--	--

		<p>An.7 F.V.Kabell cu FROR 3x 2.5mm² .</p> <p>2.496 F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m</p> <p>2.262/4 Shtrese betoni C 16/20</p> <p>4.141/a7.0 " F.V. shirit sinjalizimi per kablo nen toke ne gjithe gjatesin e linjes se ndricimit."</p> <p>Shuma II TOKEZIMI</p> <p>An.8 Shirit tok hekuri zingato 30x3 mm , + zbritje</p> <p>An.9 Maja rrufepritesezingato Dn-16mm,L0,5m</p> <p>2.496 F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m</p> <p>3.176 FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086</p> <p>An.10 Fiksues te konturit ne parapet</p> <p>An.11 Fiksues te shkarkueses ne fasade</p>		
NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre	<p>Analize F.V. Njesi e jashtme Multisplit mural 9.0 kË ne ftohje dhe 10 kË ne ngrohje.</p> <p>Analize F.V Njesi e brendshme Murale 1.3, 2.5 kË ne ftohje dhe 1.3, 2.8 kË ne ngrohje.</p> <p>2.511 Hidrant Dn 80 PN16</p> <p>2.492 F.V tub xingato dhe rakorderi Ø>1"</p> <p>2.495 F.V lavaman porcelani importi me mishelator</p> <p>2.501 F.V ëc allafrenga importi</p> <p>2.514 F.V pilete dysHEMEJE Ø40 mm</p> <p>2.491/a F.V tuba dhe rakorderi ujesjellesi PPR d=20 ~ 25mm, Pn 25</p> <p>" 2.484" F.V Saraçineske PPR 3/4"</p> <p>2.215 " F V bolier 80 liter, uje te ngrohte"</p>	A, 0-20 milion lek	1,557,795 Lek

		<p>2.516/1 F.V tuba e rakorderi PVC</p> <p>2.512/3 F.V kolektor shperndares 3/4" (5+5)</p> <p>An F.V Pompe me pulmon 24 litra</p> <p>2.596 F.V. pusete shkarkimi b/a 200x200cm, h=250cm, t=25cm</p> <p>2.2013 F V rezervuari zingato 500 litra</p> <p>2.425/2 Grope septike 12 m3 e parafabrikuar</p>		
NS- 4 A	Punime rifiniture te muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	<p>3.793 F.V Rrethim me rrjete gabion</p> <p>2.239/a Shtrese termoizoluese me polistirol t=10cm</p> <p>2.197 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa katrama</p> <p>2.219 Çati vendi e zakonshmeHD-8mmbuluar tjegull marsejeze</p> <p>2.209 Ulluk shkarkimi vertikal llamarine cingat Ø 100 mm</p> <p>2.212 Ulluk shkarkimi horizontal llamarine cingat 33 cm</p> <p>2.303/1 Suva solete h > 4 m me drejtues, me pompe</p> <p>2.310/1 Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, llaç perzier M 25</p> <p>2.331 Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m</p> <p>2.328 Patinim muri</p> <p>2.404/1 Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (brenda)</p> <p>2.404/1 Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (jashte)</p> <p>2.324a Plintuse grez</p> <p>2.386/2 V F dyer te blinduara importi.</p> <p>2.388/1 V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara</p> <p>2.395 Dyer d/alumini tek xh.</p> <p>2.375/1 F V dritare d/alumini plastike me dopio xham</p>	A, 0-20 milion lek	2,150,644 88 lek

		2.273/1a" Shtrese me pllaka graniti t=3cm davancale dritare mermeri 3cm"		
NS- 18 A	Punime topogjeodezike	Është kërkuar për arsye të zbatimit të rievimeve topografike që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë dhe punimeve topogjeodezike në objekt.		

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punëve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a.** Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a.** Inxhinier Elektrik 1 (nje)
b. Inxhinier Gjedoet 1 (nje)
c. Teknik ndertimi 1 (nje)

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- a.** Drejtues Mjeti 2 punonjës
b. Manovrator 1 punonjës
c. Hidraulik 1 punonjës
d. Elektracist 1 punonjës
e. Pllakashtrues 2 punonjës
f. Hidroizolues 1 punonjës
g. Murator 2 punonjës
h. Bojaxhi 1 punonjës
i. Saldator 2 punonjës
j. Karpentier 3 punonjës
k. Hekurthyes 3 punonjës
l. Punëtore ndërtimi te thjeshte 10 punonjës

Për punonjësit e mësipërm të paraqiten kontratat e punës te vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh. ”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit**, është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit ,stabiliznatit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll, stabilizant binder dhe asfalt.
- **Inxhinieri gjeodet**, është kërkuar me qëllim realizimin e rlevimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit.
- **Inxhinieri i Elektrik**, është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit elektrik për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin punimeve elektrike.
- **Tekniku i Ndërtimit**, është i nevojshëm për ndjekjen nga afër të gjithë punimeve ndërtimore ne baze të zërave te preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike te zbatimit si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.
- **Drejtuesit**, e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamion dhe autobetoniere
- **Manovratori**, është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si eskavator.
- **Elektrici**, është i nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike.
- **Hidrauliku**, është i nevojshëm për kryerjen e punimeve hidraulike.
- **Pllakashtruesit**, janë të nevojshëm per punimet e shtrimit të pllakave
- **Hidroizoluesit**, janë të nevojshëm për realizimin e zërave të hidroizolimeve të ndryshme sipas projektit, shtresat përkatëse sipas projektit.
- **Muratorët**, jane te nevojshem per ndërtimin e mureve.
- **Bojaxhiu**, jane te nevojshem per lyerjen e interierit.
- **Saldatorët**, shërbejnë për punimet e konstruksioneve metalike.
- **Karpentieri**, shërbejnë të vendosin armaturën dhe të realizojnë elementet prej betoni të armuar.
- **Hekurkthyesi**, shërben për të vendosur celikun në elementët prej betoni të armuar sipas formës së kërkuar

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 33 (tridhjetë e tre) persona.

Argumentimi: Numri prej 33 punonjës përfshin 10 punëtorë të thjeshtë +23 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti etj të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu per llogaritjen e numrit te punonjesve jane marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	Sasia
Eskavator me goma	1 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton	1 copë
Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 18 ton	1 copë
Autobetoniere	1 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar. Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:

- *certifikatën e pronësisë;*
 - *lejen e qarkullimit;*
 - *certifikatën e kontrollit teknik;*
 - *siguracionin;*
 - *certifikate transporti lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore dhe fotot përkatëse;*
- ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fatura tatimore përkatëse fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
 - *kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plote të punimeve.*
 - *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*
 - *Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, nuk janë të angazhuara në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor dhe do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punës së mjeteve .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në Ndërtim” dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

a. Certifikatë: ISO 9001 - Sistemi i Menaxhimit të Cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

b. Certifikatë: ISO 45001 - Sistemi i Manaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendet e Punës, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Sistemi i manaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

2.5 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”

IV. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar

çdo kërkesë funksionale ose përformance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtim orë kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Në rastet kur citohet në dokumentet e tenderit të ngarkuara në SPE termi “cilësia e parë” ose “cilësi e I-rë” ose ndonjë “markë”, ky përcaktim të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasishtë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, me të dhënat e mëposhtme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur, Punë.

3. Numri i referencës së procedurës/Lotit: REF-25474-10-18-2024

4. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “Ngritja e qendrës për trajtimin e kafshëve të rrugës”.

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV- Punime ndërtimi 45210000-2.

6. Fondi limit: 16.665.992 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) Lek pa TVSH.

7. **Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes** kuadër ose **afati për zbatimin e saj:** 112 (njëqind e dymbëdhjetë) ditë.

8. **Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 05.11.2024, ora 10.00.

9. **Procedurë e Rishpallur:**

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (*shuma , monedha*)

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit